Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Kuvendi i Komunës Rahovec*
*Skupština Opština Orahovac / Municipal Assembly Rahovec*

KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY
RAHOVEC /ORAHOVAC
Njësia Nr./Br./No 01(Kuvendi i Komunës)
Nr./Br./No 01/136 Nr. i faq/Br.str/No.pg 87
Data/Datum/Date 28/4/2026

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 shkronja c), nenit 17 dhe nenit 40 pika 2 shkronja a) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale *("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008)*, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.3, nenit 12, nenit 40 paragrafi 2 pika 2.1 dhe nenit 57 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datë 28.04.2026, miraton këtë:

# RR E G U LL O R E

**Për**

**Ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Taksa Komunale 01 Nr. 80/20, e datës 29.6.2020, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren 01 Nr. 169/21 e datës 26.02.2021, Rregulloren 01 Nr. 22/23, të datës 28.2.2023 dhe Rregulloren 01 Nr. 17/25, të datës 28.2.2025**

## Neni 1

Neni 7 i rregullores bazike, në paragrafin 1, pika 1.8, shuma "2€", zëvendësohet me shumën "3€";

Neni 7 i rregullores bazike, në paragrafin 1, pika 1.10, shuma "10€", zëvendësohet me shumën "15€";

Neni 7 i rregullores bazike, në paragrafin 1, pika 1.11, shuma "1€", zëvendësohet me shumën "3€";

Neni 7 i rregullores bazike, në paragrafin 1, pika 1.13, shuma "1€", zëvendësohet me shumën "3€";

Neni 7 i rregullores bazike, në paragrafin 1, pika 1.14, shuma "1€", zëvendësohet me shumën "3€".

## Neni 2

Neni 10 i rregullores bazike, në paragrafin 1, pika 1.5, shuma "50€", zëvendësohet me shumën "70€";

Neni 10 i rregullores bazike, në paragrafin 1 pika 1.6, shuma "50€", zëvendësohet me shumën "60€".

## Neni 3

Neni 11 i rregullores bazike ndryshohet dhe plotësohet me tekstin si në vijim:

Taksa për bashkëpagesat për shërbime shëndetësore të nivelit parësor janë të përcaktuara në Shtojcën 1 dhe në Shtojcën 2 të Udhëzimit Administrativ (MSH) Nr. 03/2024, për bashkëpagesat për shërbime shëndetësore.

**Neni 4**

Neni 17 i rregullores bazike, në paragrafin 7, shuma "600€", zëvendësohet me shumën "500€".

**Neni 5**

Neni 18 i rregullores bazike, në paragrafin 1, shuma "2€/m$^2$", zëvendësohet me shumën "3€/m$^2$".

**Neni 6**

Neni 20 i rregullores bazike, në paragrafin 1, pika 1.1, shuma "0.20€/m$^2$", zëvendësohet me shumën "0.05€/m$^2$€";

Neni 20 i rregullores bazike, në paragrafin 1, pika 1.2, shuma "0.10€/m$^2$", zëvendësohet me shumën "0.03€/m$^2$€";

Neni 20 i rregullores bazike, në paragrafin 1, pika 1.3, shuma "0.05€/m$^2$", zëvendësohet me shumën "0.01€/m$^2$€";

Neni 20 i rregullores bazike, në paragrafin 2, pika 2.1, shuma "0.50€/m$^2$", zëvendësohet me shumën "0.10€/m$^2$€";

Neni 20 i rregullores bazike, në paragrafin 2, pika 2.2, shuma "0.30€/m$^2$", zëvendësohet me shumën "0.05€/m$^2$€";

Neni 20 i rregullores bazike, në paragrafin 2, pika 2.3, shuma "0.20€/m$^2$", zëvendësohet me shumën "0.02€/m$^2$€".

**Neni 7**

Neni 21, paragrafi 1 i rregullores bazike, pas nr. 1061, shtohet nr. 1071, me tekstin si në vijim:

Nr. 1071 – Prodhimi i bukës, simiteve dhe ëmbëlsirave të freskëta – taksa 100€.

Neni 21, paragrafi 1 i rregullores bazike, në nr. 3513, shuma "2000€", zëvendësohet me shumën "2500€".

Neni 21, paragrafi 1 i rregullores bazike, pas nr. 4673, shtohet nr. 4674, me tekstin si në vijim:

Nr. 4674 – Tregtia me shumicë e pjesëve elektronike, e pajisjeve hidraulike dhe të ngrohjes, si dhe pjesulike dhe të ngrohjes, si dhe pjesëve të furnizimit – taksa 150€.

Neni 21, paragrafi 1 i rregullores bazike, pas nr. 5621, shtohet nr. 5630, me tekstin si në vijim:

Nr. 5630 – Aktivitetet shërbyese të pijeve – taksa 100€.

Neni 21, paragrafi 1 i rregullores bazike, në nr. 6419, shuma "150 €", zëvendësohet me shumën "500 €".

Neni 21, paragrafi 1 i rregullores bazike, në nr. 6910, pas tekstit "Aktivitetet ligjore", shtohet formulimi "Përveç avokaturave".

**Neni 8**

Neni 24 i rregullores bazike, pas paragrafit 1, shtohet paragrafi 2, me tekstin si në vijim:

2. Leje ndërtimi për punët ndërtimore që nuk maten me m$^2$ (metër katror), shfrytëzohen tarifat e ministrisë së linjës.

**Neni 9**

Neni 28, paragrafi 1, pika 8 e rregullores bazike, shuma "3€", zëvendësohet me shumën "3€/m²";

Neni 28, paragrafi 1, pika 9 e rregullores bazike, shuma "3€", zëvendësohet me shumën "2€/m²";

Neni 28, paragrafi 1 i rregullores bazike, pas pikës 10, shtohet pika 11, me tekstin si në vijim:

11. Gropimi për vendosjen e shtyllave elektrike me diametër 200 mm, 315 mm, 400 mm dhe 500 mm dhe lartësi 0 deri 9 metra për copë – taksa 10€/copë.

Neni 28, paragrafi 3 i rregullores bazike, pas pikës 5, shtohet pika 6, me tekstin si në vijim:

6. Leje (pëlqim) për kyçje në rrugë – taksa 10€.

**Neni 10**

Në nenin 29, paragrafi 2 i rregullores bazike, pas pikës 1, shtohet pika 2, me tekstin si në vijim:

2A. Për panot reklama (lampost), të vendosura nëpër shtyllat e ndriçimit publik 1m² deri 3m² – taksa mujore – 3€/copë.

Neni 29, paragrafi 2, pika 3 e rregullores bazike, shuma "150€", zëvendësohet me shumën "200€";

Neni 29, paragrafi 2, pika 4 e rregullores bazike, shuma "150€", zëvendësohet me shumën "200€";

Neni 29, paragrafi 2, pika 6 e rregullores bazike, ndryshohet me tekstin si në vijim:

6. Vendosja e transparentëve reklamuese mbi 12m² – taksë mujore

**Neni 11**

Neni 31 i rregullores bazike, pas paragrafit 1, shtohet paragrafi 2, me tekstin si në vijim:

2A. Shfrytëzimi i tokës komunale për vendosjen e objekteve të përkohshme – taksa mujore – 0,30€/m².

**Neni 12**

Neni 38, paragrafi 1 i rregullore bazike, pas pikës 8, shtohet pika 9 dhe 10, me tekstin si në vijim:

9. Vërtetim për mbyllje të raportit të projektit të vitit paraprak për subvencione – taksa 2€.

10. Leje (pëlqim) për ushtrimin e veprimtarisë dhe për realizimin e aktiviteteve të ndryshme – taksa 2€.

**Neni 13**

Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit, ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores për Taksa Komunale do të jetë pjesë e tekstit bazë të rregullores në fuqi.

**Neni 14**

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky ndryshim dhe plotësim i Rregullores për Taksa Komunale hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, nenit 8

dhe nenit 9 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2026 për procedurën e shqyrtimit administrativ të akteve të komunave dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose në faqen ueb zyrtare të Komunës.

**K U V E N D I I K O M U N Ë S N Ë R A H O V E C**

**01-Nr.136/26**
**Datë: 28.04.2026**

**Fatmir Iska**

**Kryesues i Kuvendit**